



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

RAPORTI VJETOR

2021

www.asd.gov.al

t: +355 (4) 2362 989/2347 298

f: +355 (4) 2362 984


e: info@asd.gov.al

Rruga e Elbasanit, Nr. 317, Tiranë



TRYEZA E LËNDËS

Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti	2
1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.....	3
1.2. Përmbledhje Ekzekutive.....	6
Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë	8
Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri	15
3.1. Depozitat në banka dhe shkk.	15
3.2. Sigurimi i depozitave në banka.	16
3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.	16
3.2.2. Depozitat e sigurueshme të individëve.....	19
3.2.3. Depozitat e siguruar të individëve.....	22
3.2.4. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.	23
3.2.5. Depozitat e siguruar të tregtarëve e shoqërive tregtare	25
3.3. Sigurimi i depozitave në shkk.....	26
3.3.1. Depozitat e sigurueshme në shkk.	27
3.3.2. Depozitat e siguruar në shkk.	29
Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.....	32
4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.	32
4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.	32
4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.	32
4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruar në banka.	34
4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk.	35
4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk.	35
4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk.	35
4.3. Administrimi i mjeteve financiare.	37
Seksioni 5 – Plani Strategjik 2021-2023 dhe iniciativat për 2021.....	41
5.1. Ushtrimet e simulimit të organizuara nga Agjencia.....	43
5.1.1. Ushtrimi i simulimit për procesin e kompensimit të depozitave të siguruar.....	43
5.1.2. Ushtrimi i simulimit lidhur me vendimmarrjen e Këshillit Drejtues.	45



5.2. Marrëveshja me BERZH për linjën e kredisë.....	45
5.3. Përzgjedhja e Bankave Agjente për periudhën 2021-2023.	47
5.4. Bashkëpunimi me partnerët strategjikë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ.	48
5.5. Aktivitete të tjera.....	49
5.5.1. Aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut.....	49
5.5.2. Aktivitete ndërkombëtare.....	52
Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës.	54
6.1. Këshilli Drejtues.	54
6.2. Struktura organizative.	55
Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.	57
Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.....	64
8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.	64
8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.	66



Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti

Ky Raport Vjetor ofron një panoramë të veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 1 Janar 2021 deri në 31 Dhjetor 2021. Raporti pasqyron aktivitetet dhe iniciativat kryesore, duke synuar që të gjithë përfituesit e skemës së sigurimit të depozitave, bashkëpunëtorët, partnerët dhe publiku të informohen mbi parimet mbi të cilat është ngritur skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri dhe angazhimin e Agjencisë si administratore e saj për të krijuar sa më shumë vlerë. Ky Raport Vjetor është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2016 dhe Ligjin nr. 132/2016, Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2021 si dhe performancën e saj financiare e flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF-të”). Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen dhe certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar.

Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues ka ushtruar tagrat që i jep Ligji për t’u siguruar që Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën dhe administrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit në raportim.

Jeni të lutur të jepni komentet tuaja për Raportin Vjetor 2021 në adresën info@asd.gov.al. Ky Raport Vjetor, si dhe raportet vjetore të mëparshme, mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare të internetit www.asd.gov.al.



1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

Të nderuar lexues,

Është kënaqësi, t' Ju prezantojmë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021. Ky raport, si çdo vit, ofron një përmbledhje të aktiviteteve të zhvilluara, përmirësimeve të realizuara dhe objektivave të arritur në periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2021.

Duke vlerësuar performancën e Agjencisë, në përputhje me standardet profesionale të mirëqeverisjes dhe përkundrejt objektivave të përcaktuar si nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë ashtu edhe nga drejtimi i Agjencisë, mund të dalim në përfundimin që këto objektiva janë realizuar me sukses.

Edhe pse situata e pandemisë Covid-19 vijoi të ketë ndikim në ecurinë normale të aktiviteteve të ndërmarra, Agjencia edhe këtë vit, duke u përshtatur me kushtet e krijuara dhe duke zbatuar rekomandimet e autoriteteve shtetërore, rikonfirmoi angazhimin e saj për të vepruar në përputhje me mandatin ligjor; për të qenë pjesë e rrjetit të sigurisë financiare në Shqipëri; si dhe për të kontribuar në stabilitetin e sistemit financiar në vend.

Në këtë këndvështrim vlerësojmë se, sipas të dhënave, ekonomia shqiptare ka treguar një rimëkëmbje të dukshme gjatë vitit 2021. Ritmi i vazhduar pozitiv i rritjes ekonomike është i fortë, me bazë të gjerë dhe i prekshëm. Rezistenca e ekonomisë ndaj ndikimit të pandemisë u dëshmuua dhe nga zhvillimet pozitive në sektorin bankar. Kështu veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua në mënyrë të ndjeshme, në kushtet e rritjes të depozitave të publikut dhe drejtimit të tyre në investime ndërbankare, tituj dhe kredi.

Trendi rritës i depozitave ndikon drejtpërdrejt në rritjen e fondeve të sigurimit të depozitave që Agjencia administron. Këto fonde përbëjnë asetin kryesor të Agjencisë për të përmbushur mandatin e saj ligjor, kompensimin e depozitave të siguruar.

Në këtë drejtim, fondet e sigurimit të depozitave dhe rritja e tyre progresive shërbejnë si garanci për depozituesit sa i takon qëndrueshmërisë së sistemit financiar në vend dhe mekanizmave të tij ligjorë,




për të krijuar një mjedis operacional sa më të sigurtë për kursimet e tyre. Nga ana tjetër ecuria e pozitive e mjeteve financiare të administruara nga Agjencia është një instrument i dobishëm për institucionet ligjvënëse, rregullatore dhe mbikëqyrëse për të vlerësuar performancën e Agjencisë dhe për të ndërmarrë në bashkëpunim me njëri-tjetrin hapat e nevojshëm në funksion të efektivitetit dhe efijencës financiare.

Siç përmendur më lart, Agjencia përgjatë vitit 2021 ka vijuar me përpjekjet për të konsoliduar në vazhdimësi veprimtarinë e saj, në funksion të fuqizimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe rritjes së kapaciteteve të saj operacionale.

Përmbledhtasi, mund të evidentojmë që një nga iniciativat kryesore është hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Agjencisë për vitet 2021-2023. Ky dokument strategjik, i cili ka përcaktuar ‘*gurët kilometrikë*’ për periudhën afatmesme, është hartuar duke marrë në konsideratë aspiratat e Agjencisë për të qenë një institucion që zbaton standardet më të larta profesionale në fushën e sigurimit të depozitave; kushtet specifike të krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19; si dhe realizimin e projekteve të parashikuara në Planin e kaluar Strategjik. Plani Strategjik përqendrohet në dy prioritet kryesore: (i) *Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale*; dhe (ii) *Garantimi i vijueshmërisë së partneritetit strategjik*. Në funksion të këtyre prioritetëve identifikohen sfidat me të cilat përballet Agjencia dhe prioritizohen objektivat kryesorë, duke planifikuar veprimtaritë e nevojshme për arritjen e tyre.

Duke marrë në konsideratë që iniciativat e planifikuara për periudhën afatmesme përfshijnë të tërë strukturën e Agjencisë, shprehim besimin se realizimi i tyre, i cili do të monitorohet periodikisht si nga Këshilli Drejtues ashtu edhe nga strukturat e posaçme për këtë qëllim, do të përafrojë akoma më shumë Agjencinë me synimin e saj për të qenë një institucion i sigurimit të depozitave që gëzon besimin e publikut.



Në përfundim, do të dëshironim të falënderonim partnerët strategjike të Agjencisë, Bankën e Shqipërisë si dhe institucionet pjesë e sistemit financiar në vend për mbështetjen e tyre; gjithashtu shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë bashkëpunëtorët dhe punonjësit e Agjencisë për angazhimin dhe profesionalizmin e tyre.

Në vijim, ju ftojmë të lexoni Raportin Vjetor dhe të na bëni me dije komentet apo sugjerimet tuaja. Sinqerisht, shpresojmë që ky raport do t' i ofrojë publikut një mundësi për të kuptuar më mirë funksionet, veprimtarinë dhe arritjet e Agjencisë.

Ju faleminderit.

Donald Duraj

Kryetar i Këshillit Drejtues

Genci Mamani

Drejtor i Përgjithshëm



1.2. Përmbledhje Ekzekutive.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2021 ka siguruar depozitat e depozituesve në 12 banka të sistemit, si dhe në 9 shoqëri kursim-krediti. Gjatë këtij viti, skema e sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim kreditit u zgjerua duke përfshirë dhe dy shoqëri kursim-kreditit të reja.

Gjatë vitit 2021, totali i depozitave të sistemit bankar ka pasur trend rritës pothuajse për gjatë gjithë periudhës. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 11.4 %, duke arritur nivelin 1,433 mld lekë në 2021. Vlera e depozitave të sigurueshme në banka që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,357.3 mld lekë, duke përfaqësuar 94.7% të totalit të depozitave. Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2021, zënë peshën më të madhe prej 47.3%, ndjekur nga depozitat në euro me 45.9%. Depozitat e sigurueshme të individëve në sistemin bankar përbëjnë 82% të totalit të depozitave të sigurueshme, ndërsa depozitat e sigurueshme të tregtarëve dhe shoqërive tregtare arrijnë 18%. Në fund të vitit 2021 numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar është 2,611,259, ndërsa numri i depozituesve tregtarë dhe shoqëri tregtare është 153,071.

Depozitat në shkk në fund të vitit 2021 kanë regjistruar një rritje vjetore në masën 10%. Totali i depozitave të këtyre subjekteve, në fund të vitit 2021 arriti në 9.6 mld lekë, nga të cilat 9.4 mld ose 98.5% të tyre janë të sigurueshme. Këto depozita u përkasin 40,900 depozituesve në shkk. Depozitat në monedhën lek zënë 83% të totalit të depozitave të sigurueshme në shkk ndërsa ato në monedhë të huaj zënë 17%.

Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka arriti 52,78 miliard lekë me një rrije prej 10.2% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2021 ishin 3.76 miliard lekë ose 5.51% më të larta se në vitin 2020 ndërsa të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2021 ishin 1.39 miliard lekë ose 13.7% më shumë se në vitin 2020. Për fondin e sigurimit të depozitave në banka Agjencia ka diversifikuar portofolin sipas maturiteteve çka ka ndikuar në rritjen e të ardhurave



nga investimi. Në fund të vitit 2021, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte rreth 6.7%. Ndërkohë, nëse marrim në konsideratë dhe linjën e kredisë prej 100 milionë Euro që Agjencia ka përfituar nga BERZH, ky raport shkon në rreth 8.19%.

Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shkk, ishte rreth 167 milion lekë duke shënuar një rritje prej 15.17% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2021 ishin 19.48 milion lekë ndërsa të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk përgjatë gjithë vitit 2021 ishin në shumën 3.16 milion lekë. Në fund të vitit 2021, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 2.42%.

Në përmbushjen e funksioneve të ngarkuara nga ligji “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në RSH”, gjatë vitit 2021, Agjencia u angazhua gjithashtu në administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (FNJ). Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 2,716 miliard lekë. Për vitin 2021 bankat kanë paguar kontribut vjetor në vlerën 664.12 milion lekë. Mjetet financiare të FNJ-së janë administruar sipas politikës së administrimit të miratuar nga Agjencia dhe Banka e Shqipërisë, si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.



Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë


Tabela e zbatueshmërisë së rekomandimeve të rezolutës të Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021

	Statusi
<p><i>Rekomandimi</i></p> <p><i>Të bashkëpunojë me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim – kreditit, për ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike të mëparshme.</i></p> <p><i>Veprimet e ndërmarra nga ASD</i></p> <p>Agjencia gjatë vitit 2021, ka vijuar kryerjen e verifikimeve on-line dhe në vend, me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, banka dhe shoqëri kursim-krediti. Gjatë verifikimeve, krahas ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportet e verifikimit të mëparshëm, rëndësi e veçantë i është kushtuar kryerjes së simulimeve teknike për raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e Agjencisë, të skedarëve për simulim/kompensim. Në rastet kur në këto simulime janë konstatuar pasaktësi, Agjencia ka bashkëpunuar me stafin përgjegjës të subjekteve për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara dhe pas korigjimeve të kryera, ngarkimi i skedarëve ka rezultuar me sukses. Në përfundim të procesit të verifikimit, Agjencia ka dërguar raportin e verifikimit, pjesë e të cilit janë edhe rekomandimet për punën në vijim.</p>	<p>Realizuar</p>



Agjencia në vijim të bashkëpunimit me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, ka organizuar takime on-line, për procesin e simulimit teknik. Konkretisht në muajin mars të vitit 2021, në takimin e organizuar me shoqëritë e kursim-kreditit u vu theksi në ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike të mëparshme, për ngarkimin e saktë të skedarëve si edhe brenda afateve kohore të përcaktuara nga Agjencia.

Gjithashtu, në datat 06 dhe 07 dhjetor 2021, Agjencia zhvilloi një ushtrim të përgjithshëm simulimi të një ngjarje sigurimi, në rast të vendosjes në likuidim të detyruar të një subjekti anëtar të skemës. Objektivi kryesor i këtij simulimi ishte testimi i bashkëpunimit me një nga bankat agjente të përzgjedhur nga lista paraprake, konkretisht banka e përzgjedhur për këtë simulim ishte Banka Credins. Në këtë ushtrim simulimi, përveç Bankës Credins, morën pjesë Banka Tirana e përzgjedhur nga Agjencia si banka që simuloi përgatitjen dhe raportimin e listë – pagesës për kompensim me paraqitjen unike të depozituesve si dhe subjekti mbështetës që Agjencia ka në dispozicion për mirëmbajtjen e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK-ut). Element i rëndësishëm në këtë simulim ishte bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, për aktivizimin e llogarisë dhe transferimin e parave pranë Bankës Agjente, si dhe pjesëmarrja e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK) në rolin e bashkëpunëtorëve të ngushtë për realizimin e këtij procesi.




Rekomandimi

Të përmirësojë kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese të Agjencisë duke kryer stres-teste në vazhdimësi për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondit të kompensimit të depozitave në banka.

Veprimet e
ndërmarra nga
ASD


Në funksion të këtij rekomandimi, Agjencia ka përfshirë në planin e saj strategjik për periudhën afatmesme metodologjinë e për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondit të kompensimit të depozitave në banka. Metodologjia është hartuar me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore. Kjo metodologji stres-testi është parashikuar të aplikohet periodikisht çdo vit bazuar në bilancet e audituara të sistemit bankar. Me asistencën e Bankës Botërore gjatë këtij tremujori, ASD ka vijuar me vlerësimin e nivelit të synuar të fondit të kompensimit të depozitave në banka. Ky vlerësim është kryer në këndvështrimin e nivelit të primit dhe do të jetë komplementar me stres-testet që Agjencia përdor.

Realizuar



Statusi

Rekomandimi	<p><i>Të përmirësojë sistemin e teknologjisë së informacionit të Agjencisë në lidhje me modulet e kryerjes së pagesave në një proces kompensimi dhe të rrisë funksionalitetin e ambientit të raportimit për të mundësuar një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit informacionit në Agjenci.</i></p>	Realizuar
Veprimet e ndërmarra nga ASD	<p>Në funksion të përpjekjeve për përmirësimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, Agjencia në bashkëpunim me BERZH, ka nisur punën për përmirësimin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK) si dhe zhvillimin e moduleve të reja, të cilat do të automatizojnë procesin e kryerjes së kompensimit. Modulet e reja do të mundësojnë verifikimin e depozituesve në një proces kompensimi si edhe evidentimin e gjurmimit e pagesës së kompensimit. Pjesë e zhvillimeve është edhe implementimi i modulit të përpunimit të ankesave të mundshme të depozituesve në një ngjarje sigurimi, si edhe implementimi i një ambienti raportimi që do të mundësojë një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit informacionit në Agjenci. Në këtë kuadër në bashkëpunim me BERZH, janë përgatitur draft termat e referencës për përmirësimin e sistemit SIRK dhe ndërtimin e moduleve të reja për automatizimin e menaxhimit të procesit të kompensimit. Aktualisht Agjencia është në fazën e bashkëpunimit me BERZH për përmbylljen e procesit të vlerësimit teknik të kandidatëve dhe më pas do të vijojë me iniciimin e procesit të implementimit.</p>	




Statusi

Realizuar

Rekomandimi Të verifikojë në vijueshmëri, rezultatet e testimeve të dijeve në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave dhe të propozojë materiale trajnuese për përmirësimin e këtyre dijeve për punonjësit e shërbimit me klientin në banka dhe shoqëritë e kursim – kreditit.


Veprimet e
ndërmarra nga
ASD

Në zbatim të këtij rekomandimi Agjencia gjatë proceseve të verifikimit kërkon nga subjektet anëtare të skemës, informacion lidhur me trajnimet që kryhen me punonjësit e shërbimit të klientit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave. Në vijim të rekomandimeve të Agjencisë, subjektet pas trajnimeve të kryera, kryejnë teste periodike për të matur nivelin e njohurive që kanë punonjësit lidhur me skemën e sigurimit të depozitave. Rezultatet e marra nga përpunimi i përgjigjeve të pyetësorëve, shërbejnë për saktësimin dhe përforcimin e njohurive të tyre në vijim. Në këto trajnime, subjektet përdorin materialin e përgatitur dhe të unifikuar nga Agjencia, i cili përditësohet në vazhdimësi, duke ndjekur dhe reflektuar ndryshimet ligjore e nënligjore të skemës së sigurimit të depozitave. Agjencia në bashkëpunim me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave ka analizuar dhe, në vijim, identifikuar hapësirat për përmirësim dhe përditësim të materialeve trajnuese që përdor. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2022 është planifikuar të rishikohet “Materiali trajnues për punonjësit e subjekteve anëtare të skemës” duke e zgjeruar dhe përditësuar me informacionin më të fundit. Gjithashtu, në funksion të informacionit të ripunuar, do të përshtatet edhe “Pyetësori për punonjësit e subjekteve anëtare të skemës”, i cili shërben



si një nga mjetet kryesore për vjeljen e informacionit në lidhje me njohuritë dhe dijet e punonjësve të shërbimit të klientelës të bankave dhe shkk-ve lidhur me skemën e sigurimit të depozitave dhe tiparet e saj.

		Statusi
<i>Rekomandimi</i>	<i>Të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.</i>	Realizuar
Veprimet e ndërmarra nga ASD	Në kuadër të këtij rekomandimi Agjencia, gjatë periudhës në raportim ka intensifikuar marrëdhëniet me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare, me qëllim sigurimin e shpejtë të likuiditetit ose plotësimin e fondeve të Agjencisë në rast të një ngjarje sigurimi. Në këtë drejtim, Agjencia dhe Banka e Shqipërisë kanë nisur bashkëpunimin për hartimin e një marrëveshje dypalëshe, e cila do të rregullojë marrëdhënien mes dy institucioneve për lidhjen e kontratave të riblerjes dhe të anasjelltas të riblerjes për titujt në pronësi të Agjencisë në rast ngjarjeje sigurimi. Gjithashtu, kjo marrëveshje do të ketë të njëjtin objekt edhe për titujt e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, i cili administrohet nga Agjencia. Agjencia në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë ka hartuar draft kontratën “Për riblerjen e titujve me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”. Kjo kontratë ka për qëllim të rregullojë transaksionet që palët lidhin për shitjen/blerjen e titujve me të drejtë riblerjeje/rishitjeje, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore	



të Agjencisë, ajo gjithashtu përcakton kushtet dhe për realizimin e transaksioneve të riblerjes së titujve. Mbetet në proces nënshkrimi i marrëveshjes dypalëshe dhe kontratës “Për riblerjen e titujve”.

Bashkëpunimi ka vijuar edhe me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, në kuadër të negocimeve që Agjencia ka zhvilluar me BERZH për lidhjen e një marrëveshje huaje për disponimin e një linje kredie të gatshme prej 100 milion Euro. Lidhja e kësaj marrëveshje u mundësua nëpërmjet mbështetjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për dhënien e garancisë shtetërore nëpërmjet marrëveshjes së garancisë ndërmjet BERZH-it dhe Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja e Huasë ndërmjet Agjencisë dhe BERZH, si dhe marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH u nënshkruan mes palëve respektive në datën 11.06.2021. Pas ratifikimit të marrëveshjes së garancisë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 92/2021, datë 1.7.2021, marrëveshja e huasë për linjën e kredisë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe marrëveshja e garancisë, kanë hyrë në fuqi në 16 gusht 2021. Linja e kredisë në dispozicion konsiderohet e rëndësishme për Agjencinë, pasi është një mekanizëm që siguron likuiditetin e nevojshëm brenda një kohë shumë të shkurtër në rast ngjarje sigurimi.

Agjencia në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, ka vazhduar të marrë pjesë në mbledhjet e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Në këtë forum Agjencia ka raportuar në lidhje me ecurinë e depozitave në subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (banka dhe shkk) si dhe mbi aftësitë e saj paguese.




Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri

3.1. Depozitat në banka dhe shkk.


Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2021 ka siguruar depozitat e depozituesve në 12 banka të sistemit, si dhe në 9 shoqëri kursim-kreditit. Gjatë këtij viti, skema e sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim kreditit u zgjerua duke përfshirë dhe dy subjekte të reja. Pas miratimit të licencës për ushtrim aktiviteti nga Autoriteti Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues i Agjencisë miratoi vendimin Nr. 3 datë 11.02.2021 për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Fast Kredit”, si edhe vendimin Nr. 25 datë 05.08.2021 për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Rrushkull One.

Në fund të vitit 2021 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,433 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 9.6 mld lekë.

Totali i depozitave në banka dhe shkk, për fund vitin 2021



Agjencia sipas të dhënave për fund vitin 2021 ka detyrimin për kompensimin e 792.2 mld lekë depozitave në banka, apo të 1,773,705 depozituesve; si dhe detyrimin për kompensimin e 6.9 mld lekë depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, apo të 20,045 depozituesve. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë, prej 799.1 mld lekë, ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe shkk, 99.1% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë vendosur depozitat




e tyre në banka, ndërsa 0.9% është detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë të vendosura depozitat e tyre në shoqëritë e kursim-kreditit.

Depozituesi në çdo bankë apo në çdo degë të bankës së huaj sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre.

3.2. Sigurimi i depozitave në banka.

Gjatë vitit 2021, totali i depozitave të sistemit bankar ka pasur trend rritës pothuajse për gjatë gjithë periudhës, me norma të ndryshimit mujor relativisht të ulëta. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 11.4 %, që i korrespondon një rritje në vlerë absolute prej 147 mld lekë.

Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2021



3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.


Në fund të vitit 2021, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,357.3 mld lekë, duke përfaqësuar 94.7% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 10.7%, ndërsa rritja në vlerë absolute është 131.5 mld



lekë. Depozitat e sigurueshme përfshijnë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit, llogaritë e kartave, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme.

Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2021, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 47.3%, ndjekur nga depozitat në euro, me kundërvlerën e tyre në lekë me 45.9%, dhe depozitat në USD, me kundërvlerën e tyre në lekë, me 5%. Krahasuar me një vit më parë vërehet një tendencë në rënie e peshës së depozitave të sigurueshme në lekë me 2.2%, dhe rritje e peshës së depozitave në euro me 2.1%, kurse pesha e depozitave në USD është pothuajse e njëjtë.

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2021



Ecuria e depozitave të sigurueshme në lekë gjatë vitit 2021 ka qenë pozitive në shumicën e periudhës, por normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të vogla, dhe vetëm në muajt janar, gusht e nëntor ka pasur një rënie relativisht të lehtë. Norma më e madhe e ndryshimit mujor ishte në fund të muajit dhjetor prej +3.3%. Në këtë periudhë këto depozita arritën vlerën prej 642 mld lekë. Depozitat e sigurueshme në valutë në muajin dhjetor 2021 përbëjnë 52.7% të totalit të depozitave të sigurueshme dhe kundërvlera e tyre në lekë ishte 716 mld lekë. Norma pozitive e


Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, shuma e kompensimit paguhet deri në nivelin maksimal të mbulimit, vetëm nëse kalon vlerën prej 100 lekësh.




ndryshimit mujor për depozitat në monedhë të huaj të konvertuara në lekë është evidentuar gjatë gjithë vitit, përveç muajit nëntor ku shënuan një rënie të lehtë me 0.3%. Rritja më e madhe prej 4.4 %, e cila erdhi si rezultat rritjes së depozitave në euro, u shënuar në fund të muajit gusht.

Peshën më të madhe të depozitave në monedhë të huaj, të shprehura në kundërvlerën e tyre në lekë, e zënë ato në euro me 45.9%, kurse depozitat në dollar të konvertuara në lekë zënë një peshë prej 5% të totalit të depozitave të sigurueshme.


Ecuria e depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave 2011 - 2021



Në fund të dhjetorit 2021, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 489.5 mld lekë (e shprehur në përqindje 36% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 867.8 mld lekë (ose 64% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).



Struktura e depozitave të sigurueshme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2.5 mln-Dhjetor 2021



3.2.2. Depozitat e sigurueshme të individëve.


Këto depozita në sistemin bankar më 31 dhjetor 2021 arritën 1,112.3 mld lekë, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme, konkretisht 82 % të tyre (norma e ndryshimit vjetor ishte 8%). Peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme të individëve e përbëjnë depozitat në lekë me 49%, ndjekur nga depozitat në euro me 45%. Gjatë vitit 2021 ecuria e depozitave të individëve në lekë ka qenë pozitive gjatë gjithë muajve të vitit me përjashtim të një rënieje të lehtë prej 1% në muajin gusht. Normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të ulta, dhe rritja më e madhe u shënuar në muajin dhjetor me 1.3%. Ndikimin në rritjen vjetore prej 8% të depozitave të sigurueshme të individëve, e kanë dhënë depozitat në euro. Në dhjetor 2021, depozitat në monedhë të huaj të shprehura në kundërvlerën në lekë kanë peshën 51%, dhe rritja vjetore e tyre ishte 11.2%. Në këtë periudhë depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë arritën shumën prej 496 mld lekë, duke shënuar një rritje vjetore në vlerë prej 57 mld lekë (+13%), kurse në monedhën origjinale u rritën me 15.7%. Këto depozita zënë peshën më të madhe të depozitave të individëve në monedhë të huaj (prej 45%). Gjatë vitit 2021 ecuria e depozitave të individëve në euro ka qenë pozitive gjatë gjithë vitit, me



norma të ndryshimit mujor relativisht të ulta. Rritja më e madhe u shënuar në muajin gusht me 3.2%, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë u rritën me 3.3%.

Depozitat e individëve në usd në monedhën origjinale, krahasuar me fundin e vitit 2020, u ulën me -6.5 %, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë (pesha e tyre 4.3%) kanë shënuar rënie vjetore me -1.2 % .

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të individëve të sistemit sipas monedhave në %-dhjetor 2021



Gjatë vitit 2021, ecuria e depozitave të sigurueshme të individëve sipas nivelit të mbulimit ka qenë pothuajse pozitive. Krahasuar me fundin e vitit 2020, depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë janë rritur me 4.8%, kurse depozitat me shuma mbi nivelin e mbulimit janë rritur me 61 mld lekë ose 10.4%. Meqenëse në dhjetor 2021, depozitat e individëve mbi nivelin e mbulimit kanë peshën më të madhe kundrejt totalit të depozitave të sigurueshme të individëve (58%), ecuria në rritjen e tyre ka ndikuar në rritjen vjetore me 8% të depozitave të sigurueshme të individëve.

Numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2021 është 2,611,259¹.

¹ Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një person i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë. Në këtë numër përfshihen depozitues me balancë zero deri në 100 lek (minimumi ligjor për kompensim), të cilët në dhjetor 2021 janë 957,290.




Ndër depozituesit individë me depozita më të mëdha se 100 lekë, 93.4% prej tyre ose 1,544,777 depozitues, i kanë depozitat deri në nivelin e mbulimit dhe përfitojnë mbulim të plotë nga skema e sigurimit të depozitave. Shuma e depozitave që u korrespondon këtyre depozituesve arriti vlerën 466 mld lekë.

Depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2021, janë 109,192 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 646 mld lekë.


Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2011-2021


fundi i periudhës



Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2011-2021

në %;
fundi i periudhës







3.2.3. Depozitat e siguruar të individëve.


Depozitat e siguruar të individëve për sistemin bankar në fund të dhjetorit 2021 ishin në vlerën 739 mld lekë dhe përbëjnë 66.4% të vlerës së depozitave të sigurueshme të individëve.

Ecuria e depozitave të siguruar të individëve në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2011– 2021



Ecuria e depozitave të siguruar të individëve në vlerë gjatë vitit 2021






Për periudhën 2011-2021, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 40% deri në 44% të totalit të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të sigurueshme dhe të siguruara të individëve 2011-2021


mld lekë; fund periudhe



3.2.4. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.


Për sistemin bankar, këto depozita në dhjetor 2021 arritën vlerën 245 mld lekë dhe gjatë vitit u rritën me 25%. Depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë u rritën me 16.3%, dhe pesha e tyre kundrejt totalit depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare ishte 9.7%, kurse depozitat me shuma mbi 2.5 mln lekë (me peshë 90.3%), u rritën me 26%.

Sipas llojit të monedhës, depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë peshën më të madhe të depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare prej 52% dhe shënuan një rritje vjetore me 30.4%, kurse në monedhën origjinale u rritën me 33.6%. Këto depozita kanë dhënë ndikimin më të madh në rritjen vjetore prej 25% të depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare. Për depozitat në euro në monedhën origjinale, gjatë vitit 2021, ka dominuar ecuria pozitive dhe vetëm në muajt prill e tetor ka




pasur ndryshim mujor negativ, përkatësisht me -0.5% dhe -2.5%. Rritjen më të madhe depozitat në euro e shënuan në muajin gusht me 12%, ndjekur nga muaji korrik me +5%. Depozitat në USD të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë një peshë prej 8%.

Struktura e shumës së depozitave të siguroshme të tregtarëve e shoqërive tregtare të sistemit sipas monedhave në % - dhjetor 2021



Sipas kategorisë së produkteve, peshën më të madhe të depozitave të siguroshme për depozituesit tregtarë e shoqëritë tregtare e zënë llogaritë rrjedhëse, me 90%.

Struktura e shumës së depozitave të siguroshme të tregtarëve & shoqërive tregtare sipas produkteve - dhjetor 2021







Në ndryshim nga situata e depozitave të sigurueshme të individëve, 90.3% e depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare janë me shuma mbi nivelin e mbulimit, dhe u korrespondojnë 11,892 depozituesve, të cilët përfaqësojnë 7.8% të depozituesve tregtarë e shoqërive tregtare. Pësia e kësaj kategorie depozituesish (me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë) si në numër ashtu edhe në shumë, në dhjetor 2021 ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me fundin e vitit 2020.

3.2.5. Depozitat e siguruar të tregtarëve e shoqërive tregtare

Depozitat e siguruar të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2021 u rritën me 21% dhe në fund të këtij viti arritën vlerën prej 53 mld lekë. Ecuria e këtyre depozitave gjatë vitit 2021, ka qenë pozitive për shumicën e periudhës, kurse një rënie të lehtë ka patur në muajt janar, shkurt e nëntor, përkatësisht me -1.45%, -0.02%, dhe -0.77%.

Ecuria e depozitave të siguruar të tregtarëve & shoqërive tregtare në vlerë gjatë vitit 2021







3.3. Sigurimi i depozitave në shkk.

Depozitat në shkk në fund të vitit 2021 kanë regjistruar një rritje vjetore në masën 10%, krahasuar me 5.7% që është regjistruar në vitin 2020. Ndryshimi mujor në përqindje i depozitave përgjatë vitit 2021 është luhatur në intervalin 0.2% deri në 1.6%, krahasuar me intervalin 0.03% deri 1.1% përgjatë vitit 2020. Ritmet e rritjes, kanë regjistruar një përmirësim krahasuar me trendin e rritjes mujore përgjatë vitit 2020, që kulmon me 1.6 % në fund të muajit dhjetor 2021.


Ecuria e depozitave të shkk-ve gjatë vitit 2021



Totali i depozitave të shkk-ve, në fund të vitit 2021 arriti në 9.6 mld lekë, nga 8.7 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2020. Në fillimin e aktivitetit të shkk-ve si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (janar 2017) kjo shumë ishte 4.1 mld lekë. Totali i depozitave në vlerë është 2.3 herë më i lartë se në momentin e përfshirjes së tyre në skemën e sigurimit të depozitave. Norma mesatare e ndryshimit vjetor për pesë vitet e fundit rezulton 19.3%.



Ecuria e depozitave të shkk-ve gjatë periudhës Janar 2017-Dhjetor 2021




3.3.1. Depozitat e sigurueshme në shkk.

Këto depozita në fund të dhjetorit 2021 janë 9.4 mld lekë dhe zënë 98,5% të totalit të depozitave, kundrejt 8.5 mld lekë që ishin më datë 31 dhjetor 2020. Këto depozita i korrespondojnë 40,900 depozituesve të shkk-ve, kundrejt 39,153 depozituesve që përfitonin nga skema e sigurimit të depozitave më datë 31 dhjetor 2020.


Depozitat e sigurueshme në fund të dhjetorit 2021, janë rritur me 10% krahasuar me një vit më parë ndërkohë që për vitin 2020 këto depozita janë rritur me 5% krahasuar me vitin 2019 siç mund të vërehet në dy grafikët e mësipërm

“Depozitat e sigurueshme në shkk, përfshijnë depozitat me afat si dhe llogaritë mbështetëse të depozituesve/anëtarëve të shkk-së.”



Në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme ndikim më të madh ka patur rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të shkk-ve. Rritja vjetore e tyre është 10%.

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2021




Depozitat në monedhë të huaj zënë 17% të totalit të depozitave të sigurueshme, si rezultat i faktit që vetëm një pjesë e shkk-ve kanë depozita në valutë.

Në fund të dhjetorit 2021, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 3.5 mld lekë (e shprehur në përqindje 37% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 5.9 mld lekë (ose 63% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).




Struktura e depozitave të sigurueshme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2 mln-Dhjetor 2021




3.3.2. Depozitat e siguruar në shkk.

Në fund të vitit 2021, depozitat e siguruar në shkk janë 6.9 mld lekë. Kjo shumë përbën 72% të totalit të depozitave, ose 73% të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të siguruar sipas tremujorëve gjatë vitit 2021






Depozitat e siguruar që mbulohen plotësisht nga skema e sigurimit të depozitave, (të gjitha depozitat midis 101 lekë dhe 2 mln lekë) në 31 dhjetor 2021, arritën vlerën 3.5 mld lekë dhe përbëjnë 37% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për kompensim për këto depozita, është e njëjtë me depozitat e siguruar plotësisht.

Depozitat e siguruar që mbulohen pjesërisht nga skema e sigurimit të depozitave, (depozitat më të mëdha se 2 mln lekë) arritën vlerën 5.9 mld lekë në 31 dhjetor 2021, dhe përbëjnë 63% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për kompensim për depozitat që sigurohen pjesërisht është 3.4 mld lekë, dhe përbën 57% të totalit të depozitave të siguruar pjesërisht dhe 36% të totalit të depozitave të sigurueshme.


Ecuria e depozitave të siguruar sipas nivelit të mbulimit për tremujor






Numri i depozituesve që i kanë depozitat deri 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2021 është 18,346. Këta depozitues përbëjnë 92% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Numri i depozituesve që i kanë depozitat në vlerën mbi 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2021 është 1,699, dhe këta përbëjnë 8% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema.

Numri i depozituesve të siguruar gjatë vitit 2021 për tremujor






Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë

4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.

4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluar ndë vite, është 52,78 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 4.88 miliard lekë ose 10.2%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2011 – 2021.

Fondi i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.


Madhësia e fondit të sigurimit të depozitave në banka përcaktohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndë vite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me Ligjin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, duke filluar nga viti 2015, primi i sigurimit të depozitave përlllogaritet në baza tremujore dhe jo më vjetore. Primi tremujor i sigurimit për subjektet bankare anëtare të skemës së sigurimit të depozitave përlllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruar, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo




muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për subjektet anëtare të skemës së sigurimit paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

Primet e sigurimit në banka (në mijë lekë)




Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2021 ishin 3.76 miliard lekë ose 5.51% më të larta se në vitin 2020. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2011 – 2021 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2021 ishin 1.39 miliard lekë ose 13.7% më shumë se në vitin 2020. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2011 – 2013 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të letrave me vlerë. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare për vitet 2014-2017 janë ndikuar nga ulja e normave të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptarë. Në vitin 2018 dhe 2021, rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi dy vjet. Gjatë vitit 2021 normat e interesit kanë qënë kostante më të njëjtin trend si vitit 2020, duke patur kështu një kthim të kënaqshëm nga investimi. Gjatë këtyre viteve gjithashtu Agjencia ka synuar të realizojë një diversifikim të portofolit në disa maturitete, gjë e cila ka ndikuar në rritjen e të ardhurave.




Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.

Në fund të vitit 2021, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 792.2 miliard lekë ose 6.83% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria më e moderuar e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2011 – 2021 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2021, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 6.66%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2011 – 2021.

Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)






4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk.

4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk.

Në përputhje me Ligjin ‘Për sigurimin e depozitave’, i ndryshuar, në Janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në shkk në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk. Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk, të cilat hynë në skemë në Janar 2017. Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shkk, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë, dhe fitimet e akumuluar, është rreth 166.67 milion lekë duke shënuar një rritje prej 15.17% krahasuar me vitin 2020.

Fondi i sigurimit të depozitave në shkk (në mijë lekë)




4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk.

Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në shkk janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare. Bazuar në Ligjin ‘Për sigurimin e depozitave’ primi tremujor i sigurimit për shkk-të përlllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në shkk në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm.




Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemën e sigurimit të depozitave nga Janari 2017, filluan të derdhin primet tremujore të sigurimit. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2021 ishin 19.48 milion lekë.


Primet e sigurimit në shkk (në mijë lekë)



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk përgjatë gjithë vitit 2021 ishin në shumën 3.16 milion lekë, e cila krahasuar me vitin 2020 është rritur me 60.46 %. Këto të ardhura janë pasojë e investimeve të fondit nga Agjencia, gjithashtu vitet e fundit është rritur portofoli i investimeve në tituj më maturitet më të lartë se dy vite, gjë e cila ka sjellë ndikim në rritjen e të ardhurave.


Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk (në mijë lekë)





Në fund të vitit 2021, depozitat e siguruar për shkk-të ishin rreth 6.8 miliard lekë ose 8.61% më të larta se një vit më parë. Në fund të vitit 2021, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruar, ishte 2.42%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruar në shkk-të dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2017 – 2021.

Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruar në SHKK (në mijë lekë)




4.3. Administrimi i mjeteve financiare.

Më 31 Dhjetor 2021, mjetet financiare të Agjencisë për fondin banka, me vlerë nominale 51.96 miliard lekë, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë ose bankës kujdestare Raiffaisen Bank International. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2021 kishte 17.32% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe në disa banka ku Agjencia mban llogari për aktivitetin




operacional si edhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas transeve të investimit më 31 Dhjetor 2021.


Mjetet financiare sipas transeve të investimit



Mjetet financiare të Agjencisë janë në masën më të madhe në lekë. Agjencia mban edhe një pjesë të mjeteve të saj financiare në valutë Euro. Në përputhje me Politikën e Investimeve, investimet në monedhe të huaj përbëjnë 10.68 % të mjeteve financiare nën administrim dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e Agjencisë me atë të depozitave të siguruara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas valutës më 31 Dhjetor 2021.



Mjetet financiare sipas valutave




Në grafikun që vijon paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2021. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim.

Bazuar në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, e ndryshuar, Agjencia ka zhvendosur rreth 54.36% të portofolit të saj të investimit në instrumente me maturitet të mbetur nga 3- 24 muaj dhe rreth 28.32% të portofolit të saj në instrumente me maturitet të mbetur mbi 24 muaj.




Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim



Më 31 Dhjetor 2021, mjetet financiare të Agjencisë për fondin e Shoqërive të Kursim Kredit , me vlerë nominale 166.078 milion lekë, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2021 kishte 13.29% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas transheve më 31 Dhjetor 2021.

Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim






Seksioni 5 – Plani Strategjik 2021-2023 dhe iniciativat për 2021.

Gjatë vitit 2021, në vijim të përfundimit të Planit Strategjik 2018-2020 dhe vlerësimit të ecurisë së tij nga strukturat e Agjencisë, u hartua dhe miratua nga Këshilli Drejtues strategjia afatmesme e zhvillimit të institucionit 2021–2023.

Të gjithë prioritetet dhe iniciativat e përfshira në këtë dokument strategjik janë përcaktuar në funksion të përmbushjes së objektivave ligjorë të parashikuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Në këtë drejtim, Plani Strategjik 2021-2023 evidenton dy prioritete strategjike kryesore, të cilat synojnë rritjen e gatishmërisë institucionale për përmbushjen e funksioneve të Agjencisë në rast ngjarjeje sigurimi, si dhe garantimin e vijueshmërisë së partneritetit strategjik të saj.

Plani strategjik përfshin edhe planin financiar afatmesëm, i cili është hartuar duke marrë më konsideratë analizën historike të treguesve financiarë të Agjencisë, të raportuara sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe në politikën e investimit të mjeteve financiare në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë. Ky planifikim financiar synon të përcaktojë drejtimet kryesore të procesit të buxhetimit në Agjenci për periudhën afat-mesme.

Për vitin 2021 njësitë organizative në Agjenci kanë kryer një sërë aktivitesh dhe veprimtarish në përputhje me parashikimet në strategjinë afat-mesme. Ndër të tjera, këto iniciativa kanë synuar testimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve operacionale, financiare dhe infrastrukturore të Agjencisë; rritjen e nivelit të gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia për një ngjarje të mundshme sigurimi si dhe përmirësimin e operacionalizimit e infrastrukturës procedurale të brendshme dhe me aktorët e tjerë; vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, bazuar në të cilin Agjencia vepron, përkundrejt *acquis communautaire* dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave si dhe përditësimin e tij përkatësisht, etj.




Duke marrë në konsideratë sa më sipër dhe rolin thelbësor që kanë institucionet e rrjetit të sigurisë financiare dhe koordinimi i ndërmjetëm, veçanërisht në këtë periudhë të ndikuar nga pandemia e COVID-19, Agjencia në vitin 2021 kreu dy simulime teknike. Konkretisht, krahas ushtrimit të simulimit me objekt procesin e kompensimit të depozitave të siguruara, me një nga bankat agjente të përzgjedhura nga Agjencia, në të cilin u përfshi Banka e Shqipërisë dhe aktorë të tjerë, u realizua edhe një simulim teknik lidhur me vendim-marrjen e Këshillit Drejtues në një ngjarje sigurimi, me fokus gatishmërinë e fondeve likuide. Synimi i këtyre simulimeve ishte testimi i kapaciteteve operationale dhe ndërgjegjësimi i aktorëve të përfshirë në një proces kompensimi mbi rolin dhe veprimtaritë që do të duhet të ndërmerren në një rast të tillë.

Njëkohësisht me kryerjen e simulimeve, Agjencia është angazhuar edhe në ndjekjen e platformës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar. Për zbatimin e këtij plani të përbashkët, që përfshin edhe bankat anëtare të skemës, Agjencia monitoroi përmirësimin e cilësisë së të dhënave nga bankat anëtare të skemës, si nëpërmjet procesit të raportimit, po kështu edhe nëpërmjet proceseve të verifikimit.

Në drejtim të sigurimit të gatishmërisë së kapaciteteve financiare në rast ngjarje sigurimi, gjatë vitit 2021, Agjencia u angazhua në diversifikimin e burimeve të huamarrjes me synim garantimin e qasjes së shpejtë në likuditet, ose plotësimin e fondeve të Agjencisë në rast se do të jetë e nevojshme. Në këtë kuadër, në datën 11.06.2021, Agjencia lidhi një marrëveshje huaje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Objekti i kësaj marrëveshjeje është disponimi i një linje kredie në gatishmëri (stand-by), në shumën prej 100,000,000 EURO (njëqind milionë Euro), me një periudhë disponibiliteti dy vjeçare në rast ngjarjeje sigurimi.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 Agjencia ka bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë për hartimin e një marrëveshje dypalëshe, e cila do të rregullojë marrëdhënien mes dy institucioneve për lidhjen e kontratave të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (Repo) për titujt në pronësi të Agjencisë në rast ngjarjeje sigurimi, si dhe të titujve titujve të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” (i cili



administrohet nga Agjencia) për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që i linden Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nga zbatimi i ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.


Po ashtu, në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë të FINSAC dhe Bankës Botërore, u punua për projektin e modernizimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ të skemës së sigurimit të depozitave, me qëllim përputhshmërinë me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/49/EU datë 16 prill 2014 “Për skemat e garantimit të depozitave”, si dhe me Parimet Themelore të Siguruesve të depozitave të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI).

Bazuar në një praktikë tashmë të konsoliduar në Agjenci, performanca e strukturave të Agjencisë përgjatë të gjithë periudhës së strategjisë afat-mesme është objekt raportimi, vlerësimi dhe rishikimi periodik nga strukturat drejtuese të Agjencisë. Në vijim janë paraqitur më në detaje disa nga aktivitetet kryesorë të realizuara në vitin 2021 në funksion të Planit Strategjik 2021-2023.

5.1. Ushtrimet e simulimit të organizuara nga Agjencia.

5.1.1. Ushtrimi i simulimit për procesin e kompensimit të depozitave të siguruar.

Në muajin dhjetor 2021, Agjencia organizoi simulimin e një procesi kompensimi të një subjekti anëtar të skemës së sigurimit të depozitave, nëpërmjet një Banke Agjente. Ushtrimi i simulimit kishte karakter të përgjithshëm dhe qëllimi i organizimit të tij midis të tjerave, ishte identifikimi i çështjeve me të cilat mund të përballlet secila nga hallkat pjesëmarrëse gjatë kryerjes së një procesi kompensimi, si dhe përfitimi i eksperiencës së nevojshme për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Aktivitetet kryesore që u simuluan në këtë ushtrim ishin kryerja e pagesave sipas listë – pagesës së kompensimit të përgatitur nga agjencia, gatishmëria operationale dhe proceduriale e bankës agjente për kryerjen e pagesës së kompensimit, si edhe raportimi i skedarëve për simulim/kompensim nga një prej bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.



Duke konsideruar si të një rëndësie të veçantë në një proces kompensimi bashkëpunimin me institucionet pjesëmarrës, në këtë ushtrim simulimi ishin ftuar të merrnin pjesë Banka Credins në rolin e bankës agjente; Banka Tirana në cilësinë e bankës së simuluar si bankë në likuidim të detyruar; Banka e



Shqipërisë, në cilësinë dhe në përputhje me funksionet e Autoritetit Mbikëqyrës në një ngjarje sigurimi; si dhe partneri IT i Agjencisë. Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar mes palëve, në këtë ushtrim simulimi morën pjesë edhe punonjësit e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK) në rolin e vëzhguesve dhe bashkëpunëtorëve të Agjencisë.

Ushtrimi i simulimit u organizua në disa faza, duke synuar përgatitjen dhe trajnimin e personelit të aktorëve të përfshirë; testimin e bashkëpunimit me Bankën Agjente të përzgjedhur për kryerjen e pagesës depozituesve të siguruar; testimin e gatishmërisë së bankës së përzgjedhur nga Agjencia për simulimin e përgatitjes dhe raportimit të listë-pagesës për kompensim si dhe kontrolli i cilësisë së listë pagesës së depozituesve; testimin e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë për aktivizimin e llogarisë dhe transferimin e parave pranë Bankës Agjente; testimin e bashkëpunimit me partnerin IT të Agjencisë; testimin e gatishmërisë teknike, si dhe procedurave operationale të Agjencisë për një proces kompensimi.

Në përfundim, u vlerësua se ushtrimi i simulimit i arriti objektivat e përcaktuara duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit dhe të kapaciteteve profesionale krahasuar me ushtrimet e realizuar më parë. Gjithashtu u evidentua një koordinim efikas ndërsektorial si dhe ndërinstitutional. Ky ushtrimi simulimi u vlerësua si mjaft i vlefshëm për rritjen e gatishmërisë së Agjencisë për t'u përgjigjur me efektivitet situatave të mundshme të një procesi kompensimi.



5.1.2. Ushtrimi i simulimit lidhur me vendimmarrjen e Këshillit Drejtues.


Në muajin korrik 2021 në Agjenci u organizua një ushtrim simulimi me temë “Vendimmarrja e KD në një proces kompensimi & burimet e financimit në rast të një ngjarjeje kompensimi”. Simulimi ishte i karakterit tematik në tavolinë dhe u krye në ambientet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Objektivat specifike të këtij simulimi ishin: (1) Vendimmarrja e Këshillit Drejtues në të gjitha fazat e një procesi kompensimi (lista e vendimeve të KD); (2) Sigurimi i likuiditeteve të nevojshme për kompensimin e depozitave të siguruara. Skenari i simulimit parashikonte pamjaftueshmëri fondesh nga ASD. Fokus i simulimit ishin gjithashtu vendimet e Këshillit Drejtues në rastet kur ASD do t’i drejtohet tregut ose Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për plotësimin e nevojave për kompensim.

Në tërësinë e tij, ushtrimi i simulimit i arriti objektivat dhe qëllimet për të cilat u organizua. U evidentua qartë një koordinim efikas midis pjesëmarrësve, dhe një nivel më i lartë ndërgjegjësimi në vlerësimin e rëndësisë së gjithë fazave të procesit të kompensimit nga ana e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

Ky simulim u konsiderua i vlefshëm për Agjencinë, veçanërisht për Këshillin Drejtues, si hallkë e rëndësishme e një procesi kompensimi si dhe për të gjitha palët e përfshira. U identifikuan disa çështje për t’u përmirësuar dhe veçanërisht nevoja e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Kjo marrëveshjeje do të konkretizonte lidhjet midis pozicioneve të punës në ASD dhe në ministri me qëllim rritjen e efikasitetit në procedurat për plotësimin e nevojës për fonde të Agjencisë, në rast ngjarje sigurimi.

5.2. Marrëveshja me BERZH për linjën e kredisë.

Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, Agjencia e Sigurimit të Depozitave vijon të ketë një nivel të lartë përgjegjshmërie dhe përmirësimi për të arritur objektivat e saj ligjorë. Për këtë qëllim, Agjencia gjatë vitit 2021 ka vepruar në mënyrë më proaktive. Megjithëse situata në sektorin bankar




shfaqet e qëndrueshme dhe me rritje të depozitave, situata e pandemisë ka sjellë nevojën për një mbështetje të këtij sektori shumë të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Ndikimet e situatës pandemike në ekonominë e vendit mund të përballnin sektorin bankar me rreziqe të paparashikuara të karakterit sistemik. Në këtë kuadër Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë kanë marrë masa mbështetëse për këtë sektor. Edhe Agjencia duke iu përmbajtur gjithmonë objektivave të saj ligjorë ka ndërmarrë hapa në mbështetje të stabilitetit të sistemit bankar e financiar. Sa më sipër, në vitin 2021 Agjencia nënshkroi një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për të përfituar një linjë kredie në dispozicion me qëllim rritjen e kapaciteteve financiare të saj, në shumën 100 milion euro.

Linja e kredisë është një mekanizëm i njohur dhe i rekomanduar në fushën e sigurimit të depozitave. Këtë mekanizëm e kanë përdorur edhe vendet e rajonit. Parimi themelor nr. 9 i Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) për burimet dhe përdorimet e fondeve, përcakton: *“Siguruesi i depozitave duhet të ketë në gatishmëri fonde si dhe të gjithë mekanizmin e financimit të nevojshëm për të siguruar rimbursimin e shpejtë të pretendimeve të depozituesve, përfshirë marrëveshje financimi për garantimin e likuiditetit.”*² .

Linja e kredisë duhet konsideruar si një mekanizëm më shumë, që u shtohet elementeve të sigurisë së skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri. Ajo rrit nivelin e mbrojtjes së depozituesve, duke përmirësuar nivelin e mbulimit si në nivel depozitash të siguruara, ashtu edhe në nivel institucionesh financiare, që janë pjesë e skemës së sigurimit të depozitave. Përdorimi i linjës do të siguronte likuiditetin e nevojshëm në rast ngjarje sigurimi brenda një kohë shumë të shkurtër (shtatë ditë pune). Linja e kredisë në rast përdorimi do të lëvrohet në monedhën Euro, duke shërbyer, në këtë mënyrë, si një instrument mbrojtës ndaj luhatjeve të mundshme të kursit të këmbimit.

² The deposit insurer should have readily available funds and all funding mechanisms necessary to ensure prompt reimbursement of depositors' claims, including assured liquidity funding arrangements. <https://www.iadi.org/en/core-principles-and-guidance/core-principles/>



Linja e kredisë është e siguruar nga një garanci shtetërore e lëshuar Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

5.3. Përzgjedhja e Bankave Agjente për periudhën 2021-2023.

Banka agjente është një nga elementët thelbësorë për realizimin me sukses të një procesi kompensimi, në rast të vendosjes së një subjekti anëtar të skemës së sigurimit të depozitave në likuidim të detyruar me vendim të Bankës së Shqipërisë. Banka agjente garanton kryerjen e pagesave të kompensimit depozituesve të siguruar në emër dhe për llogari të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Procesi i përzgjedhjes së Bankës Agjente kalon në dy faza. Faza e parë është vlerësimi i bankave anëtare të skemës, sipas kriterëve të përgjithshme dhe teknike të miratuara në rregulloren “Për kompensimin e depozitave të siguruara”. Ndërsa, faza e dytë përfshin vlerësimin e ofertave ekonomike nga bankat e përzgjedhura në listën paraprake për kryerjen e procesit të kompensimit, në rast të vendosjes së një subjekti në likuidim të detyruar nga Banka e Shqipërisë.

Procedurat e përzgjedhjes së bankave agjente përcaktohen në rregulloren “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016. Bankat agjente, që do të kryejnë procesin e kompensimit të depozitave, caktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë. Procesi i përzgjedhjes së bankave agjente nga bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave realizohet çdo tre vjet. Ky proces për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për periudhën 2021-2023 u përmbyll në muajin Dhjetor të vitit 2020. Nga kjo procedurë, me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 39, datë 15.12.2020, janë përzgjedhur fituese Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Credins sh.a. dhe Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., të cilat do të kryejnë këtë funksion për vitet 2021-2023.

Kontratat me këto banka agjente, për kompensimin e depozitave të siguruara në rast ngjarjeje sigurimi, u nënshkruan në muajin Janar të vitit 2021. Kështu u përmbyll faza e parë për vlerësimin e bankave anëtare të skemës dhe nënshkrimin e kontratës me bankat agjente të përzgjedhura fituese.



Pas përfshirjes në listën paraprake, bankat agjente janë pjesë e ushtrimeve të simulimit, si dhe e trajnimeve të posaçme të organizuara nga Agjencia, me qëllim përmbushjen me sukses të detyrimeve të tyre në rast ngjarjeje sigurimi.

Përveç kësaj bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake, rivlerësohen çdo vit për përputhshmërinë e tyre me kriteret e përgjithshme dhe teknike. Kontratat e nënshkruara me to konsiderohen të rinovuara edhe për 1 (një) vit, nëse bankat plotësojnë të gjitha kriteret e përgjithshme dhe teknike për të kryer shërbimin e kërkuar.

5.4. Bashkëpunimi me partnerët strategjikë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ.

Një nga elementët e rëndësishëm të planifikimit strategjik, që u përmbush gjatë vitit 2021 ishte edhe shqyrtimi i përputhshmërisë së kuadrit ligjor dhe rregullativ të juridiksionit vendas me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/49/EU “Për skemat e sigurimit të depozitave”, ose ndryshime të mundshme të saj, si dhe me Parimet Themelore të siguruesve të depozitave të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI).

Për përmbushjen e këtij objekti strategjik u zbatua një projekt gjithëpërfshirës, në të cilin morën pjesë ekspertë ndërkombëtarë të FinSAC të Bankës Botërore, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, si dhe të Ministrisë së Financave. Qëllimi i këtij projekti ishte vlerësimi i ndryshimeve të mundshme ligjore dhe nënligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave kryesore të skemës së sigurimit të depozitave.

Ky projekt u përmbush në vijimësi të asistencës teknike të dhënë Agjencisë nga FinSAC i Bankës Botërore gjatë periudhës 2019-2020 për vlerësimin e përshtatshmërisë së niveleve të mbulimit, si dhe zhvillimin e metodologjisë për nivelet e synuara të fondeve të Agjencisë.

Në këtë kuadër bashkëpunimi me FinSAC i Bankës Botërore do të vijojë edhe gjatë vitit 2022, me fokus bashkëpunimin e Agjencisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me mekanizmat



e financimeve mbështetëse për skemat e sigurimit të depozitave, si dhe thellimin e bashkëpunimit të Agjencisë me Bankën e Shqipërisë në drejtim të përmirësimit të kornizës ligjore të procesit të likuidimit të detyruar të bankave, si dhe procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, Agjencia do të bashkëpunojë me BERZH për studimin dhe analizimin e faktorëve për mundësinë e zbatimit të një metodologjie për përlllogaritjen e primeve të sigurimit mbi bazën e rrezikut të secilit subjekt anëtar të skemës së sigurimit të depozitave. Këto projekte kanë synuar përshtatjen më të mirë të përvojës dhe standardeve ndërkombëtare me kushtet vendase dhe kërkesat operationale të Agjencisë.

5.5. Aktivitete të tjera.

Agjencia përgjatë periudhës në raportim, në funksion të realizimit të objektivave të parashikuar në strategjinë afat-mesme 2021-2023, ka realizuar një sërë aktivitete me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë.

5.5.1. Aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut

Në kuadër të zbatimit të politikave të strategjisë së komunikimit, gjatë viteve të fundit theksi i është vënë rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet rritjes së edukimit financiar të brezit të ri. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2021 Agjencia ka vijuar punën nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit.

Në vijimësi të një tradite shumë të suksesshme dhe me ftesë të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës të Universitetit Marin Barleti, Z. Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë ofroi një leksion të hapur në praninë të studentëve dhe pedagogëve të ndryshëm të këtij universiteti. Leksione të kësaj natyre kanë marrë vëmendje shumë të madhe nga kjo lloj audience dhe shërbejnë kryesisht për prezantimin e tipareve kryesore të skemës së sigurimit të depozitave, rolin e Agjencisë si administratore e skemës, kontributin e saj në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe në një këndvështrim më të ngushtë përfitimet dhe kufizimet e kësaj skeme në Shqipëri.




Gjithashtu një iniciativë tjetër dedikuar tërësisht brezit të ri, përfshirë këtu nxënës dhe studentë, është Java Globale e Parasë. Java Globale e Parasë është një nismë ndërkombëtare e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të përgjegjshëm financiarisht në të ardhmen.

Për të pestin vit Agjencia e Sigurimit të Depozitave jep mbështetjen dhe kontributin e saj në aktivitetet e zhvilluara në Javën e Parasë, organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Kjo mbështetje realizon dhe objektivin e Agjencisë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit për skemën e sigurimit të depozitave në vend.

Tema e Javës Globale të Parasë për vitin 2021, “Kujdesu për veten, kujdesu për paratë e tua!” , nënvizoi rëndësinë kyçe që kanë njohuritë mbi një treg financiar gjithnjë e më të digjitalizuar dhe inovator. Në datën 23 mars 2021 u organizua online ceremonia e çeljes së Javës së Parasë, ceremoni e cila u përshëndet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe partnerë të tjerë. I pranishëm në këtë aktivitet ishte dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Z. Genc Mamani.





Sipas Kalendarit Javor të aktiviteteve në Javën e Parasë, Agjencia mbështeti dhe akordoi çmimet për fituesit e Kuizit European të Parasë, një konkurs mbarë-evropian i realizuar për herë të parë në Shqipëri. Ceremonia e ndarjes së çmimeve u zhvillua në ambientet e Agjencisë.

Në përputhje me ligjin organik, Agjencia ka kryer veprimtari promovionale, me qëllim informimin dhe edukimin e publikut. Ndër të tjera gjatë vitit 2021, duke marrë në konsideratë dhe parashikimet në strategjinë afat-mesme 2021 -2023 për komunikimin audio - vizual me grupet e interesit, Agjencia prodhoi fletëpalosje informuese për bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit dhe etiketa me logo të ASD-së, me një dizajn të ri dhe informacion të rishikuar, duke e bërë sa më të lehtë dhe të kuptueshëm përmbajtjen e tyre për depozituesit.

Këto materiale mund të gjenden lehtësisht pranë të gjithë rrjetit të degëve të bankave dhe shkk-ve në vendin tonë.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

**DEPOZITA TË SIGURTA
KOMPENSIM I GARANTUAR
DERI NË 2.500.000 LEKË**

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) që prej vitit 2002 është institucioni përgjegjës për administrimin e skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë. ASD siguron depozitat tuaja në çdo bankë dhe kompenson ato deri në nivelin maksimal 2.500.000 lekë, në rast se banka nuk është në gjendje të paguajë depozitat tuaja.

Të gjithë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Anëtarësimi i tyre në skemë është i detyrueshëm.

PËRFITUES nga skema e sigurimit është çdo depozitues: individ, tregtar dhe shoqëri tregtare, rezident ose jorezident, shpirtar ose i huaj, i cili ka llogari depozitë në një bankë, në lekë ose në monedhë të huaj, sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Nëse keni pyetje kontaktoni me bankën tuaj ose me ASD

+355 42 362 989
+355 42 347 298


info@asd.gov.al
www.asd.gov.al

Rruga e Elbasanit,
nr.317 Tiranë

+355 42 362 989
+355 42 347 298


info@asd.gov.al
www.asd.gov.al

Rruga e Elbasanit,
nr.317 Tiranë



Gjithashtu me rëndësi të veçantë për vitin që sapo lamë pas ishte ideimi dhe prodhimi i një video edukative që përmban informacion të dedikuar mbi kryerjen e procesit të kompensimit, me titull: Si kryhet procesi i kompensimit?


Në strategjinë e komunikimit të Agjencisë, materialet audio-vizuale janë konsideruar nga Agjencia si një mjet efikas komunikimi me publikun përmes mediave online dhe platformave sociale, të cilat japin informacionin e domosdoshëm, të përqendruar brenda një minutazhi të shkurtër dhe trajtojnë çështje që ne gjykojmë se kanë një rëndësi të veçantë.



Të gjitha videot e prodhuara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave janë të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë (www.asd.gov.al), në profilin e saj në facebook si dhe kanalin youtube të Agjencisë.

5.5.2. Aktivitete ndërkombëtare.

Në funksion të bashkëpunimit me partnerët strategjikë Agjencia gjatë vitit 2021 ka ushtruar të gjitha funksionet e saj që burojnë nga anëtarësimi me të drejtat të plota në dy forumet kryesore ndërkombëtare të siguruesve të depozitave. Në këtë drejtim, strukturat drejtuese të Agjencisë kanë marrë pjesë dhe kanë votuar për çështje të ndryshme sipas axhendës së përcaktuar të mbledhjeve vjetore të IADI-t (Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave) dhe EFDI-t (Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave). Gjithashtu, Agjencia ka marrë pjesë aktive edhe në mbledhjet e strukturave specifike të këtyre organizatave siç është Komiteti Rajonal i Evropës i IADI-t, etj.




Një aktivitet i rëndësishëm i realizuar në vitin 2021, është edhe takimi i 8-të rajonal i EFDI Ballkan, organizuar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi në muajin shtator 2021. EFDI Ballkan është një forum i institucioneve të sigurimit të depozitave të Ballkanit, anëtare të EFDI, i cili shërben si një platformë shkëmbimi idesh dhe eksperiencash, duke marrë në konsideratë mjedisin ekonomik dhe strukturat e ngjashme organizative.



Takimi i shtatorit 2021 ndjek një traditë të vazhdueshme takimesh mes autoriteteve të sigurimit të depozitave të rajonit të Ballkanit (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia), të formalizuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar prej palëve.

Tema kryesore të takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe diskutimi mbi sfidat me të cilat janë përballuar dhe do të përballen autoritetet e sigurimit të depozitave të Ballkanit në kuadër të situatave të reja emergjente të krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19. Në këtë këndvështrim, autoritetet e sigurimit të depozitave të Ballkanit diskutuan dhe përcaktuan hapat në vijim për rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me qëllim përditësimin e tij me elementët e nevojshëm për të adresuar sfidat e përbashkëta, të cilat mund të rezultojnë në kushtet e krijuara nga pandemia Covid-19.



Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës.

6.1. Këshilli Drejtues.


Bazuar në Ligin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar dhe Statutin e Agjencisë organi më i lartë drejtues është Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.

Gjatë vitit 2021 Këshilli Drejtues i Agjencisë ka në përbërjen e tij anëtarët sipas tabelës më poshtë.

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Adelina Xhemali	Anëtar	Ministri i Financave
Majlinda Demko	Anëtar	Ministri i Financave
Nexhmije Çela ³	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Bazuar në detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë, anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve

³ Përfunduar mandati më datë 21.06.2021.





të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.

Procesi i vendimmarrjes i Këshillit Drejtues, përgjatë vitit 2021, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Këshilli Drejtues në vitin 2021 e ushtroi aktivitetin e tij kryesisht nëpërmjet platformave teknologjike të komunikimit në respekt të masave parandaluese të shpallura nga autoritetet përgjegjëse si pasojë e pandemisë së Covid-19 dhe në përputhje me përcaktimet në aktet nënligjore të Agjencisë. Mbledhjet e Këshillit Drejtues gjatë vitit 2021 janë organizuar me një frekuencë të përmuajshme. Vendimmarrja e Këshillit Drejtues ka prodhuar 36 vendime në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor. Vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim miradministrimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe mbarëvajtjen operacionale të Agjencisë.

6.2. Struktura organizative.

Struktura organizative e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, i ndryshuar.

Bazuar në Statutin e Agjencisë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe në zbatim të strukturës së saj organizative Agjencia organizohet në mënyrë hierarkike, drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Sipas kësaj strukture Agjencia është e përbërë nga 7 sektorë, dhe ka në total një staf prej 29 punonjësish.



Agjencia e Sigurimit të Depozitave vijon me synimin e saj për të krijuar në vazhdimësi mundësi promovimi për punonjësit me eksperiencë profesionale, si dhe duke synuar, ndër të tjera, edhe motivimin e stafit dhe rritjen e efektivitetit në punë.

Menaxhimi me efektivitet të burimeve njerëzore të Agjencisë synon t'i shërbejë menaxhimit sa më optimal të kapaciteteve profesionale, si edhe të orientojë përdorimin me sa më shumë efikasitet të këtyre burimeve, sipas politikave të zhvillimit të institucionit. Strategjia për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në Agjenci, objektivat e synuara të saj, si edhe iniciativat që identifikohen për realizimin e tyre, janë në funksion të realizimit të objektivave strategjikë të saj. Në fokus të kësaj strategjie është zhvillimi dhe mbajtja e një mjedisi konkurrues profesional dhe social, i cili kontribuon në rritjen e besimit të punonjësve të punëdhënësi.



Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sani Frasher, Kompleksi T.I.D
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirane, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2021 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.



Çështje tjetër

Pasqyrat Financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare në 26 shkurt 2021.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.





- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Agjencisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
8 mars 2022

Mediana Klodra, Fisat






Pasqyra e pozicionit financiar.

Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
AKTIVET		
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,451,117,798
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	50,396,517,087
Aktive afatgjata materiale, neto	10	56,277,428
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	100
Aktive të tjera, neto	12	55,291,907
TOTALI I AKTIVEVE	52,959,204,320	48,051,872,323
DEYRIMET		
Detyrime të tjera	13	11,600,575
TOTALI I DETYRIMEVE	11,600,575	6,930,333
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti ("SHKK")	14	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		52,380,939,665
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK		90,664,081
TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE	52,947,603,745	48,044,941,990
TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE	52,959,204,320	48,051,872,323



Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	3,787,716,881	3,590,102,779
Të ardhura nga kontributet fillestare	16	25,520	80,164
Të ardhura nga interesat	17	1,396,826,460	1,227,990,771
Të ardhura të tjera operative	18	1,739,381	1,504,175
		5,186,308,242	4,819,677,889
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(126,324,429)	37,338,299
Shpenzime të tjera financiare	19	(33,380,279)	(4,493,905)
		(159,704,708)	32,844,394
Shpenzime operative:			
Shpenzime personeli	20	(78,505,882)	(79,892,504)
Shpenzime administrative	21	(29,308,657)	(25,944,801)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(9,499,717)	(8,795,656)
		(117,314,256)	(114,632,961)
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8, 9	(6,627,524)	(5,898,049)
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		4,902,661,755	4,731,991,273
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		4,902,661,755	4,731,991,273



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	4,902,661,757	4,731,991,273
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhura nga interesat	17 (1,396,826,458)	(1,227,990,771)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11 9,499,716	8,795,656
Rimarrje provigjioni		(5,332,886)
Lëvizja në fondin e provigjionit për instrumentet financiare	9 6,627,524	11,230,935
Ndryshimet në:		
Aktive të tjera	(50,777,307)	(178,939)
Detyrime të tjera	4,670,238	576,013
Interesi i arkëtuar	1,246,931,305	1,077,205,959
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ	4,722,786,775	4,596,297,240
AKTIVITETI INVESTUES		
Blerje e aktiveve afatgjata	11 (4,946,616)	(3,328,205)
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	(4,652,304,000)	(5,246,578,501)
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues	(4,657,250,616)	(5,249,906,706)
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit	65,536,159	(653,609,465)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8 2,388,282,103	3,041,891,569
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	2,453,818,262	2,388,282,104



Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.

	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	Totali
Më 1 janar 2020	400,000,000	76,000,000	42,788,356,194	48,594,523	43,312,950,717
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	4,711,875,918	20,115,355	43,312,950,717
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	4,711,875,918	20,115,355	43,312,950,717
Më 31 dhjetor 2020	400,000,000	76,000,000	47,500,232,112	68,709,878	48,044,941,990
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin			4,880,707,553	21,954,202	4,902,661,755
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin					
Më 31 dhjetor 2021	400,000,000	76,000,000	52,380,939,665	90,664,081	52,947,603,745




Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.


8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetencat për administrimin e këtij fondi. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është kryer në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Fondi është bërë efektiv duke filluar nga data 1 Janar 2018. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në Ligj. Banka e Shqipërisë përllëgarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributi vjetor i paguar nga Bankat për vitin e parë ishte në shumën 632.42 milion lekë dhe për vitin e dytë 650.33 milion lekë, dhe për vitin 2020 ishte 654.20 milion lekë. Për vitin 2021 bankat kanë paguar kontribut vjetor në vlerën 664.12 milion lekë. Në 31 dhjetor 2021, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 2,716 miliard lekë.

Mjetet financiare të fondit janë investuar në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitin 2021, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë. Këto mjete financiare me vlerë nominale 2.685 miliard lekë në 31 dhjetor 2021, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe depozita një javore e llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të këtij fondi, Agjencia në përputhje me politikën e administrimit të mjeteve financiare në fund të vitit 2021 kishte 10.76% të portofolit në instrumente shumë likuid, si llogari rrjedhëse dhe depozita me Bankën e Shqipërisë dhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2021.




Mjetet financiare sipas transheve të investimit




Mjetet financiare të FNJ janë në masën më të madhe në lekë. Në përputhje me Politiken e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 5.93% të mjeteve financiare nën administrim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas valutës më 31 Dhjetor 2021.

Mjetet financiare sipas valutave



Agjencia për llogari të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, administrojnë dhe mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare të këtij fondi. Agjencia përgatit dhe raporton pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme portofolin e mjeteve financiare të fondit si edhe pasqyrat financiare tremujore të tij. Pasqyrat Financiare vjetore të fondit auditohen nga shoqëri auditimi të çertifikuara e të pavarura.



8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania
T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtuesit Këshillin Drejtues te Agjensisë së Sigurimit të Depozitave dhe Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” të krijuar nga Banka e Shqipërisë sipas ligjit nr.133/2016 për qëllime të zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (“Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit me datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Çështje tjetër

Pasqyrat Financiare të Fondit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare në 26 shkurt 2021.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.



- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimit të drejtimit si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.


Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

8 mars 2022


Mediana Kodra, FCB
Kodra





Pasqyra e pozicionit financiar.

	Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	62,803,450	26,016,761
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	2,655,544,667	1,970,600,212
TOTALI I AKTIVEVE		2,718,348,117	1,996,616,973
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	10	2,315,381	2,365,622
TOTALI I DETYRIMEVE		2,315,381	2,365,622
AKTIVET NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME			
Aktivet neto në dispozicion të ANJ		1,994,251,351	1,303,587,643
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		721,781,385	690,663,708
TOTALI AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		2,716,032,736	1,994,251,351
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		2,718,348,117	1,996,616,973



Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga kontributi vjetor	11	664,127,540	654,202,246
		63,946,706	38,144,496
Të ardhura nga interesat	12		
		728,074,246	692,346,742
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(3,811,350)	888,001
Tarifa dhe komisione bankare	13		(505,000)
		(3,811,350)	383,001
Shpenzime operative:			
Shpenzime operative nga aktiviteti	14	(2,315,383)	(1,860,625)
		(2,315,383)	(1,860,625)
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8	(166,128)	(205,410)
		721,781,385	690,663,708
TEPRICA NETO PËR VITIN			
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		721,781,385	690,663,708



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

		31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	Shënime		
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		721,781,385	690,663,708
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat		(63,946,706)	(38,144,496)
Lëvizja në fondin e provigjionit për instrumentet financiare		166,128	205,410
Ndryshimet në:			
Detyrime të tjera		(216,369)	510,194
Interesi i arkëtuar		36,000,251	32,356,347
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		693,784,689	685,591,163
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale		(656,998,000)	(914,610,000)
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		(656,998,000)	(914,610,000)
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		36,786,689	(229,018,837)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të viti	8	26,016,761	255,035,598
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	62,803,450	26,016,761



Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

**Fondi i Ndërhyrjes së
Jashtëzakonshme**

Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 01 Janar 2020	1,303,587,643
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	690,663,708
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	690,663,708
Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2020	1,994,251,351
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	721,781,385
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	2,716,032,735
Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2021	2,716,032,736